[Shqiptarja.com]

E premte 1 Dhjetor 2023 - Përditësimi i fundit 11:05

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKEL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

POP 5 Lajmet me të lexuara në 5 minutat të fundit

1 Luftë/ Përfundon armëpushimi 7-diturë! Izraeli: Hamasi shkeli marrëveshjen, bëhet raketë, sërisht në luftë

2 Luftë kundër terrorizmit, DASH vlerëson Shqipërinë: Ka strategji, bashkëpunim të ngushtë me SHBA! Pajtaren kundër pasdrejtë të parave

3 Hipi në makinën me 26 kg kanabis dhe e katërt në Greqi, arrestohet Zhuli i Kukësit në Policinë e Korçës! U bëri presion kolegëve të mos e kontrolloninë (EMRI)

4 1.2 mln € dëm shtetit me dokumentpërdhimin për njësi pronë, niu gjurgj për Arbrid Çjukutajn! Pranohet kërkesa e tij për gjykim të zakonshëm

5 Z.Dhjetori, vazhdon i zazari me mgnra të njera

Kronikë

Operacioni i EUROPOL në 26 vende, Balla: 28 të arrestuar në Shqipëri, u sekuestrua 81 kg kanabis, kokainë, armë e fishekë (VIDEO)

Një operacion i përbashkët kundër trafikut të armëve, trafikut të drogës, emigrantëve dhe trafikut të qenieve njerëzore, u ndërmor në 26 vende, përfshirë edhe Shqipërinë. Në vendin tonë janë arrestuar 28 persona, janë sekuestruar armë zjarri, municion luftarak, 81 kg kanabis dhe doza kokainë. Të angazhuar 315 punonjës të Policisë së Shtetit.

■ EUROPOL aksion në të gjithë Evropën! Edhe Shqipëria e Kosova pjesë e operacionit! Sekuestrohen armë e drogë! Trafikantët u gjurmuan në aplikacione, mijëra kontrolle

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
1 Dhjetor, 09:44 | **Përditësimi: 1 Dhjetor, 09:54**

Share

Një operacion i përbashkët kundër trafikut të armëve, trafikut të drogës, emigrantëve dhe trafikut të qenieve njerëzore, si edhe goditjen e rrjeteve kriminale me rrezikshmëri të lartë është ndërmarrë në 26 vende, përfshirë këtu edhe Shqipërinë. Nga 566 persona të arrestuar në BE, 28 prej tyre janë kapur në vendin tonë. Ministri i Brendshëm, Taulant Balla thotë se nga ky operacion në Shqipëri janë sekuestruar armë zjarri, municion luftarak, 81 kg lëndë narkotike canabis dhe shumë doza kokainë.

Operacioni u zhvillua me mbështetjen e Europol, Interpol, Eurojust, Frontex, ndërsa nga Policia e Shtetit janë angazhuar 315 punonjës, ndërsa janë kontrolluar 2648 subjekte, 1525 persona, 987 mjete, 40 pako postare dhe 92 ambiente.



LEXO EDHE:
Ekzekutohet pranë shtëpisë shqiptari në Greqi, i dënuar më parë si anëtar i një bande droge! U qëllua me 3 plumba në gjoks (Emri)

"Policia e Shtetit pjesë e operacionit ndërkombëtar EMPACT JAD 2023, i cili u zhvillua njëkohësisht në 26 vende të Europës, me mbështetjen e Europol, Interpol, Eurojust, Frontex, Agjencisë Europiane të Rojës Kufitare dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese ndërkombëtare. Operacioni kishte në shënjestër rrjete të trafikimit të armëve të zjarrit, të lëndëve narkotike, të emigrantëve si dhe goditjen e rrjeteve kriminale me rrezikshmëri të lartë.

Në Shqipëri operacioni u koordinua nga Drejtoria e Europol, duke angazhuar në total 315 punonjës të Policisë së Shtetit për kontrollin e 2648 subjekteve, 1525 shtetasve, 987 mjeteve, 40 pakove postare dhe 92 ambienteve. Në vendin tonë u arrestuan 28 shtetas, u sekuestruan armë zjarri, municion luftarak, 81 kg lëndë narkotike canabis dhe shumë doza kokainë. Në total në 26 vendet europiane, gjatë këtij operacioni janë arrestuar 566 shtetas (218 për trafikimin e personave, 186 për trafikimin e drogës, 69 për trafikimin e armëve, 89 për krime të tjera); janë sekuestruar 310 armë zjarri, municion luftarak dhe rreth 1 ton drogë (626 kg kokainë, gati 300 kg cannabis, heroinë dhe lëndë të tjera narkotike", shkruan Balla.

Operacioni u ndërmor në 26 vende në të gjithë Evropën midis 13 dhe 18 nëntorit 2023 dhe përfshiu edhe kontrollet e intensifikuara në kufijtë e jashtëm të BE-së. Më shumë se 22 mijë oficerë u angazhuan në operacion, ndërsa në total janë arrestuar 566 persona, 218 për trafikimin e personave, 186 për trafikimin e drogës, 69 për trafikimin e armëve, 89 për krime të tjera. Ndërkohë, janë sekuestruar 310 armë zjarri, municion luftarak dhe rreth 1 ton drogë, 626 kg kokainë, gati 300 kg cannabis, heroinë dhe lëndë të tjera narkotike.

Pjesëmarrësit

Shtetet Anëtare të BE-së: Austria, Bullgaria, Kroacia, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Luksemburgu, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovenia, Spanja dhe Suedia.

Vendet jo anëtare të BE-së: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova*, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Turqia, Ukraina dhe Mbretëria e Bashkuar.

Agjencitë e BE-së: Europol, Eurojust dhe Frontex.

Rezultatet e EMPACT JAD 2023:

22 488 oficerë të përfshirë
163 hetime të filluara
288 774 subjekte të kontrolluara
215 273 persona janë kontrolluar
67 277 makina të kontrolluara
5 225 paketa/pako postare të kontrolluara
999 ambiente të kontrolluara
2 229 hyrje të paligjshme
566 arrestime (218 në lidhje me kontrabandën e emigrantëve, 186 në lidhje me trafikun e drogës, 69 në lidhje me trafikun e armëve të zjarrit, 89 në lidhje me krime të tjera)
Janë identifikuar 114 dokumente të falsifikuara
310 armë (84 armë automatike, 65 pistoleta, 59 pushkë, 22 granatahedhës, 16 revole, 7 karabina, 6 armë gjahu, 4 armë të konvertuara, 2 pistoleta ajri, 42 të tjera)
20 206 copë municion
Pothuajse një ton drogë: duke përfshirë 626 kg kokainë, pothuajse 300 kg kanabis, heroinë dhe birmë marijuanë

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: policia e shtetit europol droge

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Komision hetimor vetëm për çështje konkrete,jeni dakord me propozimin e PS?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

U kap duke transportuar drogë, dënohet i riu shqiptar në Gjermani: Më kthenë sa më shpejt në vendin tim
29 Nëntor, 19:00

FOTO+EMRI/ U kap duke dorëzuar kokainën me vlerë 139 milijë euro në Irlandë, dënohet me 2 vite burg mekaniku shqiptar
29 Nëntor, 09:50

Përgjimet që tronditën policinë/ Gazetari Dema: 70 efektivë hetohen nga SPAK! Ka shefa që janë dorëhequr! Hajdari: Duhet operacion i paméshirshëm
27 Nëntor, 21:44

'Im bir la universitetin për të punuar në shtëpi bari në Britanë', rrëfimi i babait shqiptar: E mora vesh vonë
26 Nëntor, 23:10

Përgjimet/ Europol i dorëzon Shqipërisë listën e policëve me SKY e EncroChat, bashkëpunojnë me grupet kriminale! Në janar-nëntor u arrestuan 69 efektivë

Sokol Dema
26 Nëntor, 15:43

Zhblokohen gradat në Policinë e Shtetit, hapet garaf 572 vende vakante nga 'drejtues i parë' te 'komisar'

Sokol Dema
26 Nëntor, 14:26

Në kërkim prej një viti për prodhim dhe trafik droge, arrestohet 27 vjeçari në Korçë
24 Nëntor, 13:51

Lamallari për Report TV: Nga fillimi i 2024-ës rriten me 30% pagat e efektivëve, në fokus policët në terren që përballen drejtpërdrejt me krimin
22 Nëntor, 15:23

Largimi i Ardi Veliut, kush janë 26 kandidatët për kreun e AMP-së! Mes tyre edhe ish-drejtues në polici

Sokol Dema
21 Nëntor, 17:08

Aksioni i SPAK me 11 urdhër-arreste, burime për Report Tv: Pas zbërthimit të mesazheve në aplikacionin 'Sky-Ecc' po hetohen edhe 56 efektivë policie
20 Nëntor, 21:09

VIDEO/ I kishte fshehur poshtë sediljeve së makinës, policia greke sekuestron 75 kg marijuanë, arrestohet shtetasi grek
19 Nëntor, 12:06

Itali/ 20-vjeçari shqiptar arrestohet për trafik droge! Në shtëpi i gjendet kokainë dhe euro
18 Nëntor, 18:59

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje